



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, pas debatit të zhvilluar në seancën plenare të mbajtur më 30 maj, 1 dhe 4 qershor 2018, me propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe me harmonizimin e tekstit me grupet parlamentare të LDK-së, PDK-së, PSD-së, AAK-së dhe Nismës, miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Të rishikohet dhe të paraqitet për ndryshim në Kuvendin e Republikës së Kosovës Ligji i Punës dhe paketa ligjore që garanton sigurinë në punë, të drejtat e punëmarrësit dhe organizimin sindikal në Republikën e Kosovës, duke përfshirë në plotni kërkesat e Sindikatave të Kosovës dhe të sanksionohet zbatimi i Kontratës Kolektive.
2. Të rishikohet dhe të ndryshohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës vendimi për pagën minimale.
3. Të iniciohet ndryshimi dhe amendamenti i legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e punës për të favorizuar punësimin e grave dhe vajzave.
4. Të përshpejtohet puna e Komisionit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në procedimin e ligjit për biznesin social.
5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale ta paraqesë raportin e detajuar mbi gjendjen e zbatimit të të drejtave të punës dhe të projektit që ka iniciuar për subvencionim e pagës dhe atë për punësimin e një anëtari të familjes në familjet pa asnjë të punësuar.
6. Zbatimi pa vonesa i Marrëveshjes me Republikën e Shqipërisë për të hequr lejen e punës për të punësuarit nga ky vend në përputhje këtë marrëveshje që aktualisht është në zbatim në Republikën e Shqipërisë.

Nr. 06-R- 007
Prishtinë, më 04.06.2018

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.